



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN	
Q2. Nro / Br.	1596/23
Nr. F.R. / Br. st	
Data / Datum	29.12.2023
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRISË

Procesverbali i takimit të dytë publik me qytetarë i kryetarit të Komunës për punën

1 vjeçare Janar-Dhjetor 2023

Takimi i dytë publik me qytetarët i kryetarit të Komunës

Datë: 29.12.2023

Ora: 11:00

Vendi: Qendra e Kulturës “Hasan Prishtina”

Takimi është hapur nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, i cili para qytetarëve të pranishëm ka prezantuar raportin për punën një vjeçare (2023) të ekzekutivit.

Ferit Idrizi, kryetar i Komunës së Vushtrrisë, falënderoi qytetarët pjesëmarrës në takim. E vlerësoj shumë të rëndësishëm komunikimin e drejtpërdrejt me qytetarët, me prezantu para jush se çka kemi punuar, është rruga e vetme që e përmirëson jetën e qytetarëve kur kemi një bashkëpunim të afërt.

Ju falënderoj edhe një herë që keni gjet kohën që të bisedojmë për punën një vjeçare të qeverisjes komunale. Jemi bashkërisht me nënkyetarin e Komunës, si dhe drejtorët komunal, kështu që jemi të gatshëm që t'i përgjigjemi çdo pyetje apo kërkesë që ju mund të keni.

Fillimi i juve po paraqes një përbledhje të shkurt të punëve që kemi bërë gjatë vitit 2023.

Prioritet i imi dhe i qeverisjes time ka qenë rinia, këtë e kemi premtuar edhe gjatë fushatës, po i jam përkushtuar që nga momenti që e kam marrë detyrën. Për këtë arsyе ne i kemi subvencionuar me 100% 11 profile profesionale në qendrën gjermane të trajnimeve Diakonie, pra çdo i ri, çdo e re, që ka pas dëshirë me pas një zanat për me pas më lehtë me u gjet në tregun e punës e ka pasur këtë mundësi dhe një numër shumë i madh janë duke i kryer këto trajnime. I kemi subvencionuar në shkathtësi të buta, vitin e kaluar i kemi pas 400 bursa me 50%, këtë vit e kemi pasur pa kufi, shumica i kanë kryer trajnimet në kompaninë SPEEX dhe shumë prej tyre janë punësuar kanë mësuar gjuhën gjermane, gjuhën angleze, teknologji të informimit. Kemi ndarë bursa për studentë në nivelin bachelor dhe master, e kemi shtuar numrin e bursave në 80, dhe e kemi rritur shumën e bursave, e kemi rritur më shumë se Universiteti i Prishtinës, se UP i ndan 500 euro, ndërsa ne i kemi rritë në 600 euro. Ju kemi dalë në ndihmë edhe studentëve që janë në gjendje të rëndë sociale, përmes kërkesave që i kanë bërë edhe atyre ju kemi dalë në ndihmë. Për herë të parë i kemi subvencionuar edhe studentët që studiojnë jashtë vendit. Jemi komuna e vetme që kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me York University, ku kemi ndarë 5 bursa të plota dhe 5 bursa me bashkëfinancim 50% universiteti dhe 50% studenti. Tek rinia i kemi subvencionuar të gjitha klubet e sportit që veprojnë në Komunën e Vushtrrisë, mandej kemi dhënë projekte në fushën e Kulturës ka qenë thirrja për aplikime që kanë fituar për projekte. Kemi ndarë edhe 70 bursa në bashkëpunim me IADK-në për katër profile profesionale të teknologjisë së përpunimit të ushqimit për gra.

Drejtoria e Arsimit, arsimi mbetët padyshim një nga prioritet kryesore të punës sime, ku gjatë vitit 2023 fokus i kemi dhënë ngritjes së cilësisë dhe përmirësimit të kushteve të punës për nxënës dhe mësimdhënës. Kemi organizuar në mënyrë digitale garat e diturisë për shkollat fillore, të mesme në gjimnaze, gara këto që do të ndikojnë drejtpërdrejt në mësimnxëniet dhe në ngritje të cilësisë. Nxënësit fitues dhe mësimdhënësit hartues të pyetjeve të këtyre garave u shpërblyen në vlera

monetare. Në vazhdën e ngritjes së cilësisë padyshim që rol të madh luan edhe digjitalizimi i shkollave, ku kemi bërë furnizimin me tabela smart, me TV led, si dhe pajisje të teknologjisë informative, investime të cilat kapin vlerën e 158.185 eurove. Për të përmirësuar infrastrukturën shkollore, kemi bërë renovimin e shkollave, ndërtimin e platove të shkollave, ndërtimin e depove të shkollave, ndërtimin e rrethojave dhe fusha sportive, investime këto në vlerë të 634.743 euro. Si dhe këtë vit kemi vënë gurthemelin për ndërtimin e shkollës “Mustafë Venhari”, në vlerë prej 1.078.258.00 euro, shkollë kjo moderne me standarde më të larta që do të ndikojë drejtpërdrejt në mësimdhënie dhe mësimnxenie.

Tek Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, aktivitetet kulturore gjatë vitit 2023 kanë qenë të shumta. Kemi shënuar me aktivitete të ndryshme 101 vjetorin e klubit të qytetit, ndërsa diasporën tonë e kemi pritur me manifestimin “Ditët e Diasporës”, ku kemi organizuar aktivitete të shumta për gjashtë ditë të ndara në dy pjesë, për të vazhduar me pjesën e dytë të aktiviteteve kushtuar diasporës “Sofra e mërgimtarit”. Pastaj, kemi organizuar festivalin ndërkombëtar të filmit Fest Castle në Kalanë e qytetit, pastaj manifestimin tradicional “Takimet e Poeteshave Shqiptare”. Për herë të parë në Vushtrri kemi arritur një marrëveshje me Teatrin Kombëtar të Kosovës, ku edhe është formuar edhe grapi i baletit të qytetit. Po ashtu, gjatë këtij viti kemi përkrahur artistët vushtrri, ku kemi organizuar “Muajin e pikturës”, ku më pastaj është hapur edhe eksposita nga piktorët pjesëmarrës në këtë organizim. Gjatë vitit 2023 kemi ndarë 70,000.00 euro subvencione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, 7 mijë euro për shkrimitarët vushtrri, 6 mijë euro për piktorët vushtrri, si dhe 6 mijë euro për organizimin e festivaleve në kuadër të DKRS për Ansamblin e Qytetit “AKV Hasan Prishtina”, si dhe bendeve të ndryshme muzikore.

Në Drejtorinë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural, përkrahja për fermerët e vyeshëm vushtrrias nuk ka munguar as gjatë vitit 2023, ku si Komunë kemi qenë në mbështetje të plotë të tyre, ku kemi dyfishuar shumën e subvencioneve. E kemi gjetur me 140.000 euro, në dy vite qeverisje subvencionet i kemi dyfishuar në 300.000 euro në vitin 2023, dhe 350.000 euro janë planifikuar për vitin 2024. Për 276 fermerë vushtrrias kemi ndarë serra në bashkëpunim me Islamic Relief Kosova, në vlerën prej 360.000 euro. Kemi subvencionuar ujiten e tokave bujqësore me 50% mbulueshmëri nga Komuna e Vushtrrisë, për herë të parë kemi subvencionuar litrën e qumështit me 5 cent, për të vazhduar me subvencionimin për krerë dele, dhi 4 euro, për koshere të blerëve 4 euro, subvencionimi për krerë buallice me 100 euro.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, është një prej drejtorive që vërtetë ka punuar jashtëzakonisht shumë në pastrimin e përrrockave, përrrenjve dhe lumenjve, fal punës që është bërë ju e dini që Komuna e Vushtrrisë prej vërvshimeve ka shpëtuar më së lehti krahasuar me shumë komuna të tjera që i kemi përreth. Prapë është duke vazhduar punën në pastrimin e të gjitha përrrockave në të gjitha fshatrat, pra jemi të përkushtuar që t'i pastrojmë të gjitha. Është pastruar dhe është rregulluar shtrati i lumi Silnica, lumi Tërstena dhe lumi Podranqa.

Tek Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, vetëm gjatë vitit që po lëmë pas në qytet dhe pothuajse në secilin fshat kemi shtruar 16.707m asfalt. Kemi filluar realizimin e projektit që ndryshtetës do të njihet edhe si kryevepra e Vushtrrisë, e që është ndërtimi i sheshtë së bashku me parkingun nëntokësor në vlerë prej 3.000.000 euro. Pastaj, ndërtimi i tri rrugëve që njihen si arterie të qytetit e që janë, rruga “Avni Saraçi”, “Bekim Berisha-Abeja” dhe “Lumni Surdulli”, të gjitha

këto rrugë do të jenë të ndërtuara sipas standardeve më të larta e që ndërtimi i tyre kap vlerën 1.129.986 euro. Ndërsa, pas kërkesës së shumë qytetarëve, kemi filluar ndërtimin e dy rrugëve tejet të rëndësishme siç është rruga “Drenica”, e cila është në bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës, kjo rrugë do ketë 7m gjerësi, trotuar dhe shteg të bicikletave. Si dhe, rindërtimin e segmentit rrugor “Pestovë-Druar”, që përfshin zgjerimin e rrugës, rrugë kjo e cila lidh fshatrat Artakollit me magjistralen Prishtinë-Mitrovicës, rrugë kjo e gjatë 15.54m.

Nga Drejtoria për Shërbime Publike, janë bërë 20.000m kanalizim, duke përfshirë pothuajse secilin fshat dhe qytetin e Vushtrrisë, për të vazhduar tek ndërtimi i rrugëve me kubëza me gjithsej 2486m, ndërtimi i trouareve 1860m, pastaj ndërtimi i urave në Akrashticë, Studime, Duboc, Ropicë, Smrekonicë, për të filluar pastrimin dhe zgjerimin e lumenjve në Smrekonicë, Studime dhe lumin Podranqa. Po ashtu, është punuar edhe në zgjerimin e ndriçimit publik në çdo pjesë të Komunës së Vushtrrisë. Si dhe, një pikë e fortë ishte dhe mbetet pastrimi dhe mirëmbajtja e qytetit. Për fshatin Studime kemi hartuar një projekt shumë të mirë që trajton rrugën komplet po edhe shtratin e lIMIT, do të shpallim tenderin në fillim të vitit dhe do të kërkojmë nga ministria që të na ndihmojë me bashkëfinancim.

Tek Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, shëndetësisë i kemi kushtuar kujdes të veçantë gjatë këtij viti, ku përveç ofrimit të shërbimeve shëndetësore për pacientët, kemi investuar edhe në krijimin e kushteve më të mira të punës përmantelbardhët tanë. Gjatë këtij viti kemi blerë dy autoambulanca me të gjitha pajisjet përcjellëse, me pas kemi blerë edhe dy automjete terreni për nevojat e QKMF-së, një për transportin e pacientëve në hemodializë dhe një për realizimin e vizitave shtëpiake. Gjatë këtij viti kemi ndarë 301.284 euro subvencione, ku këtu hyjnë subvencionet për fëmijët e posalindur, subvencionet për shërim, subvencionimi i qerasë për familjet në nevojë, subvencionimi për realizimin e vizitave shtëpiake me Islamic Relief. Theks dhe fokus të veçantë i kemi kushtuar ofrimit të shërbimeve shëndetësore për gratë lehonë dhe fëmijët, personat e moshës së tretë dhe personave me aftësi të kufizuar, ku kemi arrit marrëveshje me Islamic Relief Kosova për realizimin e vizitave shtëpiake, në shumën prej 787.924, ku janë angazhuar 7 mjekë të përgjithshëm dhe 19 infermierë.

Në drejtorinë e Administratës, shërbimet kanë qenë shumë të mira për qytetarët, kanë qenë të kënaqur me shërbimet që i ka ofruar. Jemi komuna e parë që kemi krijuar platformë digitale për regjistrimin e diasporës vushtriase. Po ashtu, edhe këtë vit kemi ofruar lehtësira administrative për diasporën, ku kemi krijuar sportele të veçanta për diasporën, kemi ofruar shërbime edhe ditën e shtune, si dhe kemi ofruar parking pa pagesë vetëm për diasporën.

Në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, punët janë kryer me shumë efikasitet, nuk e di që ka pritur ndonjë lëndë. Edhe pagesat janë bërë në drejtori që qytetarët ta kenë më të lehtë të marrin shërbime.

Si vit kur e përbledhim e vlerësoj që ka qenë një vit shumë sfidues, sfida ka qenë kontrata kolektive e mësimdhënësve, ku Ministria e Arsimit në qeverinë e kaluar ka nënshkruar një kontratë kolektive për t'i paguar shujtat e mësimdhënësve, transportin dhe tash Ministria nuk i ka qitë paratë, tash këto mjete duhet t'i paguajnë komunat, do të thotë përmes procedurave gjyqësore të përbabarimit dhe këtu jemi munduar të shpëtojmë atë që shpëtohet dhe me dalë korrekt edhe me

mësimdhënësit. Çka kemi bërë është që i kemi pyetur juristët dhe kemi shkuar përmes procesit të ndërmjetësimit, me procesin e ndërmjetësimit i kemi shpëtuar mbi 1 milionë euro, që do të thotë kanë hequr dorë nga kamata nga ana e paditësve dhe disa taksave, ne kemi heq dorë nga ankesa në shkallën e dytë.

Krejt në fund, ne e kemi bërë shpenzimin e buxhetit për këtë vit 90 përqind në investimet kapitale, ndërsa si total është 96%. Ka vend për të thënë që ia kemi dalë suksesshëm, me këtë rast unë i falënderoj stafin tim sepse çka është bërë mirë është bërë me punën e stafit të komunës. I falënderoj të gjithë qytetarët që gjatë gjithë kohës kam qenë në kontakt me ta, kontaktet me qytetarët i kam mbajtur edhe çdo të premte ku i kam pritur personalisht në zyrën time, po edhe ditëve tjera kur kanë ardhur qytetarët i kam pranuar. Juve ju falënderoj shumë që keni gjet kohën me marrë pjesë në këtë diskutim publik dhe ju bëjë thirrje të gjithë qytetarëve që të marrin pjesë në diskutimet publike se këto janë shumë të rendësishme.

Me pas fjala ka kaluar tek qytetarët, të cilët kanë paraqitur kërkesat e tyre.

Ismajl Haziri, kryetar i lagjes urbane Dardania, kam ardhur këtu me obligim të banorëve, për t'i paraqitur kërkesat që kanë mbetur të pazgjidhura dhe në bashkëpunim me organet e komunës t'i zgjidhim. Kërkesa e parë është rruga “Avdyl Mehmeti”, “Aziz Salihu” dhe “Mehmet Kosumi”, kërkesë e qytetarëve është që nga viti 2019 të pazgjidhura edhe pse ka hytë projekt në vitin 2021 akoma nuk është zgjidhur. Kërkesa e dytë është, një pjesë e lagjes nuk është furnizuar me kontejnerë edhe pse GIZ-i gjerman i ka nda mjetet për qytetin ato janë përdorur diku tjetër, ne asnjë kontejnerë nuk e kemi marrë. Kërkesa e tretë, është kërkuar nga qytetarët që të ndahet një tokë për ndërtimin e stacionit të autobusëve. Kërkesa tjetër është falja e tatimit në pronë, nëpër të gjitha komunat është zgjidhur te ne jo. Kërkesa tjetër është që Komuna të vendos një tabele jashtë ndërtesës aty ku po hidhen mbeturinat, se po ja japid një pamje shumë të keqe, tabele zyrtare që është. Një kërkesë e veçantë është që semaforët që janë vendosur nuk po funksionojnë dhe ajo është e rrezikshme, kjo është shumë me rëndësi që të zgjidhet. Kërkesë e qytetarëve është që të vendoset një tabele me vendbanime, rrugë, komunikacioni, ato janë hequr kur e kanë shtruar rrugën dhe nuk i kanë vendos më. Sa i përket çështjes së ndërmarrjeve private, si KEDS, Ujësjellësi, nuk mund të komunikosh me ta fare, 100 herë i thërrret kurrikush nuk lajmërohet, se për shembull shtyllat janë duke u rrëzuar nuk vjen askush, kisha kërkuar bashkëpunim. Kërkesa e fundit, neve kryetarëve e lagjeve urbane që dy vjet e gjysmë nuk na keni paguar asnjëherë që nga zgjidhja jonë, pagesa duhet të bëhet konform rregullores, ju kisha lut që të bashkëpunojmë.

Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, sa i përket pyetjes së parë tek ndërtimi i tri rrugëve që ne i kemi përmend dhe janë në planifikim edhe vitin e ardhshëm. Pyetja e dytë, mungesa e kontejnerëve nuk e kam pas këtë informacion dhe do të intervenojmë menjëherë. Pyetja e tretë, stacioni i autobusëve, është problemi i pronës, ministria e Drejtësisë më ka njoftuar që e ka fituar rastin që ka qenë në gjykatë dhe ne jemi shumë të interesuar tash përmes procedurave të rregullta me kthyë atë pronë të komunës dhe me fillu. Stacionin nuk e kam premtuar në fushatë se e kam ditur që nuk kemi vend, ajo ka qenë arsyja. Pyetja e katërt, falja e tatimit në pronë, na veç e kemi fal tatimin në pronë, në seancën e Kuvendit para dy muajve kemi propozuar faljen e tatimit në pronë për vitin 2023 edhe pse është paguar nga shumica e qytetarëve, por tash ne do të gjejmë forma dhe mundësi që në mënyrë retroaktive me e fal. Tabelat zyrtare për shpallje, është shpall se

tash po dëshirojmë ta bëjmë në mënyrë elektronike, po tash operatorët po bëjnë ankesa dhe derisa po ndahet drejtësia në OSHP neve po na kushton si komunë, përndryshe ka me qenë tabelat LED në hyrje të qytetit, në tri hyrjet e qytetit keni me i pas informatat për çdo gjë që ndodh në Komunë. Pyetja tjetër, mos funksionimi i semaforëve, është pronë e ministrisë së Infrastrukturës, kemi bërë kërkesë me shkrim që ata me bë pranimin teknik se e kanë lënë në gjysmë rrugën, këtë rrugën që kalon nga Nedakoci e deri tek Smrekonica, është pronë e ministrisë, kemi bërë kërkesë në momentin që na e kthejnë neve si pronë të komunës, ne i marrim përgjegjësitë edhe për mirëmbajtje edhe për ndriçim. Tek tabelat e vendbanimeve, jemi komuna e vetme në Kosovë, ne të gjitha fshatrat i kemi ngjitë tabelat me emrat e fshatrave, mund të ndodh që diku është hequr, por kemi qenë shumë të kujdeshshëm. Sa i përket lejeve të ndërtimit, harta zonale nuk është se duhet së ta bëjmë pari planin urban që jemi në atë proces, por ju siguroj të gjithëve që krejt lejet e ndërtimit çka i ka lëshuar Drejtoria e Urbanizmit kanë qenë në përputhje me ligjin për ndërtimin. Tri leje i kemi refuzuar na, i ka miratuar ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kemi me i bë transparente që le ta dinë qytetarët ku kemi thënë ne jo, është institucion më i lartë në moment që e kanë pru lejen prej tyre i kemi thënë okej ndërto sa ta ka lëshuar lejen, po tri leje i kemi refuzuar. Sa i përket KEDS, Ujësjellësit dhe kompanive regionale është e vërtetë që nuk janë përgjegjësi e jona, por po të siguroj që çdo kërkesë që ka ardhur prej qytetarëve i kemi përcjell, e di që në shumë vende kanë intervenuar. Për Ujësjellësit kam kontakte ditore të vazhdueshme, se jemi duke e mbështetur kompaninë regionale për shkak të qytetarëve, jo për shkak të kompanisë. Pagesa e kryetarëve të lokaliteteve që i kemi zgjedh, kemi tentuar disa herë me e bë pagesën, është një çështje ligjore, duhet me gjet një zgjidhje ligjore se nuk po kemi mënyrë qysh me i pagu, tek ne ekziston vullneti, e vlerësoj shumë punën tuaj edhe bashkëpunimin që e kemi dhe do ta gjejmë mundësinë për t'i paguar.

Bekim Sopjani, nga fshati Samadrexhë, jemi duke bërë kërkesë për një rrugë prej vitit 2012 është e pa asfaltuar, janë diku 350m, është rruga “Fehmi Bunjaku”, jemi dy lagje aty.

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, ju kam premtuar që të paktën kemi me e shtru në zhavorr, mirëpo që 11 muaj është kontrata në OSHP, janë dy operatorë të Vushtrrisë. I kemi rrugë në zhavor diku 14 rrugë edhe ka pas ankesë, kemi mbetur për atë. Kanë me u krye ato punë, veç ka mbetur në pamundësi për shkak të lëndëve që janë në OSHP.

Hamdi Shyti, përfaqësues i fshatit Oshlan, rruga Oshlan-Pantinë e di që është nën pronësi të Ministrisë së Infrastrukturë, megjithatë vërehet një laramani në ndërtimin e kësaj rruge, pjesa e vjetër që është ndërtuar para tri vitesh ndryshon prej kësaj pjesës së re, pjesa nga Pantina është me trotuar, me shenja të komunikacionit shume bukur, megjithatë pjesa tjetër që graviton nga lagija Sejdui në Pantinë e deri në Oshlan nuk ka trotuar fare. E di që ndoshta nuk është kompetencë e juaja, por a keni kontakt për këtë ju dhe në qoftë se ata nuk e rregullojnë trotuarin a është mundësia që këtë ta bëjë Komuna e Vushtrrisë. Çështja e dytë, kam bërë një kërkesë me shkrim në drejtorinë përkatëse për ndriçimin e këtyre fshatrave, nuk kemi marrë përgjigje. Tre, tabelat e vendbanimeve Oshlan dhe Gurbardhë nuk kanë figuruar asnjëherë, e kujt është përgjegjësia.

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, sa i përket trotuarit që ka mbetur në gjysmë ne kemi mundësi ta planifikojmë në vitet e ardhshme, ka mundësi të bëhet trotuari. Sa i përket ndriçimit, jemi duke e zgjeruar rrjetin, veç po ju tregoj që nuk kemi qare pa e analizuar edhe një

herë mirë se po ka kosto shumë të lartë shpenzimet e ndriçimit. Ne vetëm shpenzime të ndriçimit i kemi paguar diku afér 500 mijë euro. Për ndriçim jemi duke e shtrirë rrjetin dhe synimi është me shtri komplet rrjetin edhe nëpër fshatra, se është shumë i domosdoshëm, por ndoshta duhet ta analizojmë a t'i lëmë ndezur deri në mëngjes apo deri në orën 12. Tabelat do të vendosen nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Rasim Lahu, përfaqësues i fshatit Skoçan, kërkesa ime rruga për fshatin Skoçan. Në vitin 2016 është trasuar rruga e re, është shtruar deri diku, është zgjeruar, në 2016 ku na është mundësuar të shkojmë pak më lehtë unë personalisht dhe tre bashkëfshatar kemi vënë gurthemellet për shtëpi të reja, janë themeluar tri ferma, një e lopëve, deleve dhe e dhive. Gjendja e asaj rruge për çdo ditë ka shkuar duke u dëmtuar. KEDS na ka premtuar që do të shtrij rrjetin e energjisë elektrike. Kërkohet nga ju që të na shtrohet rruga.

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, jam në njoburi, se kam qenë deri aty ku përfundon rruga. Ne e kemi fut në prioritet është përvitin 2024-2026, ajo rrugë e ka koston diku mes 700 mijë deri në 800 mijë euro, në qoftë se ministria që e përmende ti ka gatishmëri na hyjmë në bashkëfinancim 50 me 50 %, në 2025 ne ja prejmë shiritin. Sipas buxhetit që e kemi ne, nuk kemi pas mundësi me bë diçka më shumë, por në prioritet është ajo rrugë. Do të shkoj tek ministria për bashkëfinancim.

Ramadan Rashani, banor i fshatit Beçiq, krejt këto kërkesa që janë duke i bërë momentalisht, a ekziston ndonjë zyre ku duhet me ardhë këta me u anku, unë me sa dëgjova je duke i pritur të premten dhe ditëve të tjera. Nuk po e shoh të arsyeshme çka me i bë këto pyetje këtu kur t'i kanë bërë edhe në komunë dhe me humb kohë. Për çka fshati Beçiq nuk ka ndriçim.

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, çdo mënyrë të komunikimit me qytetarët e pranoj. Çështjen e ndriçimit e përmenda, do ta ketë një kosto, por duhet ta gjemë një zgjidhje me qenë edhe ndriçimi edhe me qenë më racionale.

Zymer Musa, banor i fshatit Bukosh, kemi problem në rrugën "Lavdim Shaqiri", për shkak të problemeve të tri familjeve dhe e kanë bllokuar një rrugë nuk mund të kalojmë, janë diku 30-40 familje që nuk mund të kalojnë andej. Kanë problem tri familje por po na dëmtojnë 40 familje të tjera. Kanë qitë pengesa që po na dëmtojnë. Kanë qenë edhe Policia. Kërkoj nga ju që të na ndihmoni duke i hequr ato pengesa.

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, më vjen keq, ju kërkoj ndjesë për çdo dëm që ju bëhet. Kur është asfaltuar rruga ka hyrë në pronë private dhe ju është shmangur pronës publike, në një moment pronari privat e ka qitë Kadastrin dhe i ka dalë prona e tij dhe tash ne kemi me u marrë, unë sot e dërgoj Inspeksionin dhe ato pengesa hiqen, ndërkaq pronën private nuk e zgjidh atë problem Policia, kemi dashur ta zgjidhin në mënyrë institucionale. Jemi duke u marrë me këtë rast derisa të zgjidhim.

Fikrete Krasniqi, banore e fshatit Maxhunaj, e kam një ankesë për serrën që e kam fituar, këtë vit është dëmtuar tërësisht. Kemi bërë një ankesë, ka ardhur komisioni dhe më thanë qe veç llastiku duhet të ndërrrohet. Është dëmtuar për shkak të erërave të forta.

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, i kam qitë ekipet, do të bëhet vlerësimi dhe do ju dalim në ndihmë. Ekipi ka dalë për të bërë vlerësimin e dëmeve.

Beqir Beqiri, qytetar nga Vushtrria, unë e mbaj mend vitin 89 kur është vërvshuar Vushtrria, prej atëherë nuk kemi pas vërvshime në Vushtrri, tash brenda dy viteve u bënë vërvshimet për shkak të keqpërdorimi që janë prish shtretërit e lumenjve, dhe vërvshimet i marrin tokat bujqësore.

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, ne kemi filluar pastrimin posa e kemi marrë mandatin, pastrimin e përrrockave, edhe në Smrekonicë edhe çdo kund, na kanë mbetur edhe disa pjesë të vogla. Nuk dua t'i vë notë qeverisjes time, mirëpo ka qenë një menaxhim perfekt që është përmend në krejt Kosovën menaxhimi i të reshurave atmosferike. Kisha kërkuar edhe prej juve që të na ndihmoni në mbrojtje të ambientit.

Takimi ka përfunduar në ora 12:45.

Procesmbajtëse:

Mirjeta Duraku

Mirjeta Duraku

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë

Ferit Idrizi

Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRISË

Lista e pjesëmarrësve në takimin publik me qytetarë

Datë: 29.12.2023

Nr.	Emri-Mbiemri	Numri i telefonit	Nënshkrimi
1.	AJGT KOSUMI	,	Kosum
2.	Msmail Haxim	Haxim
3.	MusLafë Halili	..	Halili
4.	Muratza Dallku	Dallku
5.	Famoli Shyti	..	Shyti
6.	XHEMAL BOSKU	Bosku
7.	RAMAZAN RASHATI	Rashati
8.	ZYTER PUSA	Pusa
9.	A BZO T SHYTI		AB
10.	Brahim Maroci	Maroci
11.	Rosim Morina	Morina
12.	FAZLI RASTICA	...	Rastica
13.	AFRIM BERTESHI	..	Berteshi
14.	FIRRETE KRASNIQI	-1 --	Krasniqi
15.	FLAMUR BERTESHI	-II --	Berteshi
16.	BERKIM Sopjani		Sopjani
17.	BAJRAM KRASNIQI		Krasniqi
18.	Qanile Jkajta qlo		Qanile



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRISË

Lista e pjesëmarrësve në takimin publik me qytetarë

Datë: 29.12.2023

Nr.	Emri-Mbiemri	Numri i telefonit	Nënshkrimi
19.	Fakelite Hyseni	... - - -	Hyseni
20.	HABIBE JASHARI	... - - -	Jh Jl
21.	GANIMETE MEHOCCI	... - - -	Ghecholli
22.	Merita Brahmuni	... - - -	S. Brahmuni
23.	Dhurataz Brahmuni	071 - - - -	Dhurataz
24.	Nazmije Memiq	071 - - - -	Nazmije
25.	Zemrige Arbely	... - - -	Roseva
26.	Fladilca Abdurrahmani	071 - - -	Fladilca
27.	Izet Abdurrahmani	071 - - -	Izet
28.	Akter Ab Dervari	071 - - -	Akter
29.	Flutur Sogonjera, Ekonomia Online	071 - - -	Flutur
30.	Rasim Lahu	071 - - -	Rasim
31.	ICMI Felez	071 - - -	Felez
32.	Shaban Krasniqi	071 - - -	Shaban
33.	fortunz Krasniqi /DUMM	071 - - -	fortunz
34.	Hana Mihajlovic	071 - - -	Hana
35.	Medina Bunjerku	071 - - -	Medina
36.	Isef Ishajef	071 - - -	Isef



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRISË

Lista e pjesëmarrësve në takimin publik me qytetarë

Datë: 29.12.2023

Nr.	Emri-Mbiemri	Numri i telefonit	Nënshkrimi
37.	ERGIXI SUNGURI	...	<i>Erguci</i>
38.	MALIQ FERIZI	...	<i>Ferizi</i>
39.	LORIK MAXHANI	...	<i>Lorik Maxhani</i>
40.	Bearomin SIFAZA	...	<i>Bearomin Sifaza</i>
41.	Reuni Ahmeti	...	<i>Reuni Ahmeti</i>
42.	Bujar Shatrolli	...	<i>Bujar Shatrolli</i>
43.		...	
44.			
45.			
46.			
47.			
48.			
49.			
50.			
51.			
52.			
53.			
54.			